



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/23/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. M.S ndaj gjyqtarit D.B, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 14.10.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. M.S ndaj gjyqtarit D.B për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Me datë 18.09.2024 av. M.S ka paraqitur kërkesë për inicim të procedurës disiplinore për gjyqtarin D.B për shkak të pretendimeve për shkelje disiplinore. Me datë 25 Shtator 2024 lidhur me ankesën është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Parashtruesi i ankesës në shkresën e tij ka deklaruar se arsyeja e paraqitjes së ankesës ka të bëjë me veprimet e kundërligjshme të gjyqtarit dhe sjelljet jo korrekte në raport me të si avokat. Sipas tij, gjyqtari D.B ka refuzuar të nënshkruaj formularët për kompensim si avokat mbrojtës i të pandehurit B.R, ku avokati në fjalë ka qenë i caktuar si avokat sipas detyrës zyrtare i ftuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës. Av. M.S ka deklaruar se me datën 23.07.2024 është ftuar nga zyrtarët e gjykatës që të marrë pjesë në seancën dëgjimore në cilësinë mbrojtësit të të pandehurit, meqë rast edhe i pandehuri e ka kundërshtuar kërkesën e Prokurorisë për caktimin e masës së arrestit shtëpiak dhe ka mohuar kryerjen e veprës penale, ku në këtë situatë edhe avokati sipas detyrës zyrtare ka paraqitur arsye për kundërshtimin e kërkesës.

Ndër të tjera av. M.S ka deklaruar se me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprahe, të pandehurit B.R ju është caktuar masa e Arrestit Shtëpiak në kohëzgjatje prej 1 muaji dhe palët konform dispozitave ligjore janë udhëzuar që ekziston e drejta për ankimim të vendimit, gjë të cilën i njëjti e ka parashtruar. Mirëpo, sipas tij, në fillim të muajit Shtator ka shkuar personalisht në zyrën e gjyqtarit për nënshkrimin e formularëve, por i njëjti ka deklaruar se refuzon të nënshkruaj formularët, me arsyetimin se kur është në pyetje arresti shtëpiak, nuk paraqitet nevoja fare për avokatët dhe nuk ka pas nevojë të ushtrohet ankesë.

Sipas tij, gjyqtari ju është drejtuar me fjalët “*avokat na e liro zyrën se kemi një seancë*” për çka avokati në fjalë – këtu parashtruesi i ankesës ka reaguuar duke i thënë se “*nuk jam person që hyjë në zyre pa leje, por ju lutem mos e komplikoni situatën pa nevojë, ose tregoni nëse keni ndonjë arsye tjetër pse jeni duke vepruar kështu vetëm ju, kur asnjëherë deri më tani nuk kam pasur probleme të kësaj natyre*”.

Sipas avokatit, gjyqtari i është drejtuar me fjalët “*shko te kryetarja e gjykatës le ta nënshkruaj ajo*”, por sipas avokatit i ka thënë se “*mos ta komplikojmë situatën pa nevojë, nuk po e shof të arsyeshme me shku te kryetarja, kur kjo është punë e juaja dhe mund ta kryeni ju*”, por sipas tij përkundër kësaj dhe në prezencën e dy bashkëpunëtorëve të tij dhe avokatit Mentor Neziri ka kërkuar që t ia lirojë zyrën, duke deklaruar se “*edhe nëse urdhëron kryetarja, unë nuk i nënshkruaj formularët, nëse don mund ti nënshkruaj ajo*”.

Avokati ka deklaruar po ashtu se gjyqtari në fjalë në shenjë anulimi i ka vijëzuar me nga dy vija formularët, të cilat i ka bashkangjitur në ankesë.

Sipas avokatit, me veprimet e tij, gjyqtari në fjalë ka treguar sjellje të papërgjegjshme dhe jo korrekte, në kundërshtim me dispozitën e nenit 5 par. 2 pika 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe ndaj të njëjtit janë plotësuar kushtet që të filloj procedura disiplinore dhe pas vlerësimit të të gjitha rrethanave të njëjtit ti shqiptohet edhe masa konform ligjit në fuqi.

Në lidhje me pretendimet e parashtruara, gjyqtari D.B ka deklaruar se paraqitësi i ankesës nuk ka treguar se cili ka qenë veprimi i kundërligjshëm në lidhje me mos nënshkrimin e faturave dhe pagimin e shpenzimeve për të cilat i njëjti nuk ka të drejtë si mbrojtës, pasi që sipas tij, referuar dispozitës ligjore nga nenin 56 par. 1 pika 2 të KPRK-së i pandehuri duhet të ketë mbrojtës edhe “*nga arrestimi, gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës deri sa ai gjendet në paraburgim.. nga momenti i marrjes në pyetje për herën e parë për veprë penale të dënueshme me të paktën pesë(5) vjet burgim*”, dhe sipas tij, në rastin konkret, masa të cilit i është caktuar të pandehurit nuk është mara e paraburgimit pasi që ai ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak dhe po ashtu dënueshmëria e veprës penale ka qenë deri në 3 vite. Sipas tij, avokati mbrojtës pretendon se ka paraqitur kërkesë që nuk është kontestuese, mirëpo nuk ka të drejtë pagese, duke u bazuar në dispozitat e referuara më lartë.

Sa i përket pretendimeve për sjellje jo korrekte, gjyqtari ka deklaruar se avokati në fjalë ka ardhur në zyre pa lejen paraprake të tij por vetëm është futur në zyre përderisa gjyqtari ka qenë në fillim të një seance gjyqësore, me qëndrim prej një personi që respektin për gjykatë dukshëm e ka të munguar, duke u hequr se i din të gjitha dhe se të tjerët nuk din fare ose din shumë pak, ku është drejtuar me kërkesë për nënshkrim të faturës me fjalët se nuk ka nevojë për komplikim, është gjë e thjeshtë, kështu veprojnë të gjithë etj, dhe përkundër kësaj sipas gjyqtarit i ka shpjeguar arsyet se pse refuzon që të paguaj gjithmonë duke ju referuar dispozitave më lartë, mirëpo avokati ka insistuar në shpjegimet e tij të gabuara dhe me një siguri që është për tu habitur, ku pas kësaj sipas gjyqtarit e ka drejtuar te Kryetarja e Gjykatës për të vendosur përfundimisht për këtë çështje. Ndërsa, sipas tij është plotësisht i rrem pretendimi se ka deklaruar “*shko te kryetarja e gjykatës le ti nënshkruan ajo*”, përkundrazi sipas gjyqtarit i ka thënë avokatit se nëse kryetarja e gjykatës e vlerëson ndryshe atëherë do ta nënshkruaj, por pas

kësaj avokati i ka deklaruar se “ *atëherë nuk ke qare pa e nënshkru*” për çka gjyqtari i ka kërkuar menjëherë të liroj zyrën.

Ndërsa, sa i përket formularëve të cilëve ju është rënë me vije, gjyqtari ka deklaruar se fillimisht formularët i ka dorëzuar një avokat tjetër në emër të avokatit M.S ku formularët kanë qëndruar pothuajse një javë në zyre, ku pastaj ka ardhur avokati në fjalë që është djali i avokatit M.S që ti marrë formularët e panënshkruar dhe i është thënë arsyeja se pse nuk janë nënshkruar, duke kërkuar përmirësimin e tyre ose eventualisht të ju drejtohet Kryetares së Gjykatës. Mirëpo, sipas tij të njëjtit formular janë dorëzuar përsëri në zyrën e gjyqtarit, e për të mos rrezikuar që të nënshkruaj nga volumi i madh i punës dhe gabimeve pa dashje që mund të bëhen, ju është rënë vije, ku sipas tij në çdo rast vepron kësi soji me të gjithë avokatët të cilët në çdo rast tregojnë mirëkuptim duke i sjellë formularët e tjerë me përmirësimet e nevojshme.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka ardhur në përfundim se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit D.B.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Në rastin konkret, Autoriteti Kompetent nuk ka gjetur se gjyqtari D.B ka kryer shkelje të paraparë me nenin 5 par. 2 pika 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ashtu siç pretendohet nga ana e parashtruesit të ankesës, e që ka të bëjë me mos trajtimin siç kërkohet me ligj të palëve në procedurë, përfaqësuesit e tyre, dëshmitarët, dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë.

Për autoritetin kompetent nuk është kontestues fakti se avokati M.S ka marrë pjesë si avokat i caktuar në mbrojtjen e të pandehurit B.R, në çështjen gjyqësore të evidentuar PP.nr.607/24, ndërsa po ashtu nuk është kontestues as fakti se gjyqtari në fjalë ka refuzuar nënshkrimin e formularëve duke dhënë arsyet të cilat i njëjti i ka konsideruar si të ligjshme në rastin konkret.

Mirëpo, Autoriteti Kompetent ka vlerësuar se aplikimi i gabuar dhe jo i drejtë i legjislacionit në fuqi nga ana e gjyqtarëve gjatë punës së tyre ditore, mund të jetë shkak për ushtrimin e mjeteve juridike nga ana e palës se pakënaqur, e qe kjo çështje lidhet me aspektin profesional të gjyqtarit dhe e njëjta mund të shërbejë si kriter në vlerësimin e përfundimit të gjyqtarit të caktuar, por jo të konsiderohet shkelje disiplinore nga ana e të njëjtit.

Gjyqtari i çështjes është i detyruar të kujdeset për zbatimin e akteve normative, në mbajtjen e rendit në gjykatore dhe ruajtjen e dinjitetit të gjykatës, si dhe të kujdeset që të pengojë çdo keqpërdorim të të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë.

Autoriteti kompetent vlerëson se ankesa disiplinore në përgjithësi paraqet pakënaqësitë e shprehura nga avokati për veprime të gjyqtarit të cilat nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore, pasi veprimet e tilla të gjyqtarit mund të jenë subjekt i vlerësimit në instanca më të larta.

Çdo kërkesë e palëve në një çështje gjyqësore (pavarësisht nëse ka të bëjë me kompensime të shpenzimeve të avokatit a po kërkesë e ndonjë natyre tjetër) duhet të trajtohet nga ana e gjyqtarit dhe të njoftohet me shkrim parashtruesi i kërkesës si dhe të vendoset në shkresat e lëndës përkatëse.

Andaj, gjyqtari i çështjes është i obliguar që avokatin ta njoftoj me vendimin mbi refuzimin e nënshkrimit të faturave, a po të njëjtin ta njoftoj për përmirësimet e nevojshme, si dhe t'i mundësoj mjetet juridike ankimore.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/23/24, me datë 14.10.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë